



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 233/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Ferki Xhaferi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Vlerona Maliqi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Emin Beqiri nga Komuna e Lipjanit, subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të publikimit në spot të fushtës zgjedhore, objektin publik të Policisë së Kosovës dhe përfshirjen e personit privat pa lejen e tij në aktivitetin promovues zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuar ankesa Anr.233/2019 e datës 05.10.2019, e paraqitur nga Emin Beqiri nga Komuna e Lipjanit, subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, i SHQIPOHET gjobë, në lartësi prej 9,500.00 (nëntëmijë e pesëqind) euro, për shkak të publikimit në spot të fushatës zgjedhore, objektin publik të Policisë së Kosovës në Prishtinë dhe përfshirjen e personin tjetër pa lejen e tij, në aktivitetin promovues zgjedhor dhe Detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 05.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.233/2019, nga Emin Beqiri, nga Lipjani, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilat pretendon se kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Mefail Bajqinovci, më datë 04.10.2019, rreth orëve të mbrëmjes, ka shpërndarë një videoincizim, në të cilin ka përdorë foton e këtij ankuesit Emin Beqiri, pa lejen e tij, me ç'rast paraqitësi i ankesës pretendon se nga ana e këtij kandidati është përdorë pozicioni i tij në Policinë e Kosovës, si dhe është përdhosë, emri, pozicioni, dinjiteti dhe pozita e tij si drejtor si dhe hapësirat e objektit të Policisë së Kosovës, veprim ky i cili sipas tij, bie në kundërshtim me rregullat e KQZ-së. Në fund ka kërkuar nga PZAP-i, që ankesa të pranohet dhe shkelësi të sanksionohet. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur një CD, një kopje të kartës së identitetit dhe një kopje të ID-së, së tij, në cilësi të provave materiale.

Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në përgjigjen në ankesë të datës 06.10.2019, theksoi se ankesa është e palejuar dhe e pabazuar, me arsyetimin se Emin Beqiri, nuk ka legjitimitet aktiv, për ushtrimin e ankesës sa i përket procesit zgjedhor, sipas nenit 119 par.1 të LZP-së. M tej ka theksuar se paraqitësi i ankesës nuk ka bërë një përshkrim të hollësishëm të datës, kohës, vendit të shkeljes së pretenduar ashtu siç parashihet me rregulla zgjedhore. Sipas tyre, xhirimi i spotit në fjalë, është bërë më datë 19 shtator 2019, jashtë periudhës së fushatës, jashtë afatit të heshtjes zgjedhore dhe jashtë objektit të Policisë së Kosovës, respektivisht në trotuar dhe jo në objektin e Policisë së Kosovës, fakt ky i cili provohet pikërisht nga CD, që ankuesi i ka bashkangjitur ankesës. Me asnjë dispozitë ligjore të LZP-së, nuk sanksionon subjektet politike dhe kandidatët e tyre për pretendime të shkeljes së legjislacionit zgjedhor në fushën dhe periudhën kohore të parafushatës, aq më tepër nga pretendimet e një parashtruesi të paautorizuar. Sa i përket pretendimit të paraqitësit të ankesës, për përdorim të fotos pa lejen e tij, paraqitësi i përgjigjes në ankesë ka theksuar se fotoja në fjalë nuk është përdorë nga kandidati i tyre për deputet por është publikuar më parë nga një faqe e gazetës kallxo.com, në spotin i cili ka ndodhur më datë 19 shtator 2019, nga ora 22:37 minuta dhe në asnjë mënyrë nga ana e kandidatit të tyre për deputet nuk është përdhosë fotoja e palës ankuese të paautorizuar. Në fund kanë shtuar se publikimet në rrjetet sociale para fushatës nuk përbëjnë shkelje të legjislacionit zgjedhor në fushatë, ashtu siç edhe publikimet në rrjetet sociale nuk përbëjnë shkelje të LZP-së, të heshtjes zgjedhore, të publikuara në fushatë, duke kërkuar nga PZAP-i, që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe e palejuar. Paraqitësi i përgjigjes në ankesë, si dëshmi për pretendimet e tij, ankesës i ka bashkangjitur dy fotografi të printuara, në cilësi të provave materiale.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragraf 2, të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, vlerëson se pas shikimit të shkresave të lëndës si CD-në, dhe dy foto të prezantuara si prova materiale nga ankuesi, e cila CD dhe foto, janë shpërndarë nga ana e kandidatit për deputet Mefail Bajqinovci nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ka ardh në përfundim se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka shkelur Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, konkretisht nenin 33 paragrafi 1 pika b) e LZP-së, në të cilin përcaktohet se: *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”,* në këtë rast kandidati për deputet Mefail Bajqinovci nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka publikuar video duke përdorur objektin publik të Policisë Kosovës dhe vetë Policinë e Kosovës, në një spot politik, për fushtaë zgjedhore që i bie në kundërshtim me dispozitën e lartcekur.

Nga e njëjta CD-video dhe dy fotografit e prezantuara nga pala ankuese, paneli konstaton se kandidati për deputet Mefail Bajqinovci nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, ka

përdorur në spotin e tij zgjedhor, personin privat, në këtë rast ankuesin pa lejen e tij, që të ankuesi ka nxitur provokim me rastin duke e përdorimit të fotos e tij në fushatë zgjedhore, në kuptim të nenin 33 paragrafi 1 pika l) të LZP-së, në të cilin përcaktohet se: *“Përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Subjekti politik ka bërë shkelje në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti gjatë aktivitetit të tyre zgjedhor, nga ana e njërit prej kandidatëve të tyre për deputet, janë përdorur fotografitë në të cilat është Emin Beqiri, si dhe objekti i Policisë, gjatë së cilës video në mënyrë të qartë bëhet thirrje për të votuar, atë si kandidat për deputet, si dhe subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që mbahen më datë 6 tetor 2019. Duke marrë parasysh faktin se në foton e publikuar në video është i përfshirë edhe Emin Beqiri, për të bërë fushatë dhe atë pa lejen e tij, dhe përveç kësaj është përdorë edhe objekti i Policisë së Kosovës, e pranoi ankesën si të bazuar.

Sa i përket pretendimit të paraqitësit të përgjigjes në ankesë, se Emin Beqiri nuk ka legjitimitet aktiv për paraqitjen e ankesës, Paneli vlerësoi se ky pretendim nuk qëndron për faktin se me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme, respektivisht dispozitën e nenit 119 par.1, përcaktohet se; *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të KZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë një ankesë pranë KZAP-it”*. Se personi në fjalë ka legjitimitet në këtë çështje për të paraqitur ankesë, ka të bëjë me faktin se është përdorur fotoja e tij, me rastin e promovimit të subjektit politik si dhe duke marrë për bazë se fotoja në fjalë përdoret në konotacion negativ dhe pa pëlqimin e të njëjtit, me ç’rast të njëjtit ia cenon dinjtetin.

Sa i përket pretendimit të ankuesit, se fotoja e Emin Beqiri-t, është publikuar edhe më parë, nga një faqe e gazetës kallxo.com, Paneli vlerësoi se kjo nuk përbën justifikim që fotoja në fjalë të përdoret nga të tjerët pa lejen e tij. Fotoja nga ana e mediumit përdoret me qëllim informues të opinionit, e që është detyrë parësore e mediumit rreth ndonjë ngjarjeje, ndërsa

përdorimi nga ana e kandidatit për deputet, si në këtë rast është bërë gjatë aktivitetit promovues të kandidatit Mefail Bajqinovci, në fushatë zgjedhore.

Sa i përket pretendimit për mosprecizim të vendit, kohës dhe datës kur ka ndodhë shkelja, Paneli, vlerëson se afati për ankuesin fillon nga momenti kur ankuesi, bie në dijeni për shkeljen që është bërë, në kuptim të nenit 5 paragrafi 5 të Rregullës dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, në këtë rast ankuesi ka rënë në dijeni lidhur me shkeljen me datën 04.10.2019, në orët e mbrëmjes, që rezulton të jetë në fushatën zgjedhore.


Po ashtu si rrethanë PZAP-i, e mori edhe faktin që subjektin politik në fjalë, i'u dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë dhe ta përmirësojë shkeljen e bërë, mirëpo subjekti politik në fjalë, në përgjigje në ankesë, ka theksuar se ky veprim i tyre nuk përbën shkelje sipas dispozitave ligjore të legjislacionit në fuqi, duke mos ofruar asnjë dëshmi se nga ana e tyre janë ndërmarrë veprime në drejtim të evitimit të shkeljes, siç kërkohet me nenin 120 paragrafi 1 pika a) e LPZ-së, veprime këto të cilat kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, si në dispozitiv të këtij vendimi, në kuptim të nenit 120 paragrafi 1 pika c) të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 118 par.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.233/2019 më datë 06.10.2019

Kryesues i Panelit

Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.1 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes pranimit të këtij vendimi.